



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 61, datë 30.03.2022

**PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT “SiCRED” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike dhe matematike të shoqërisë “SiCRED” sh.a., siç paraqiten në 31 dhjetor 2021, sipas përlogaritjes së shoqërisë.**
- 2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2021 të provigjoneve teknike dhe matematike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:**

Provigjonet teknike dhe matematike në 31 dhjetor 2021	Lekë
Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total	235,731,745
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	<i>13,229,969</i>
Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total	222,501,776

- 3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**